

VENDIM
Nr.785, datë 4.6.2008

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE QEVERISË SË REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS, PËR LEHTËSIMIN E PASOJAVE, TË SHKAKTUARA NGA TËRMETI I DATËS 12.5.2008, NË PROVINCËN SICHUAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 8 e 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, t’i shtohet fondi prej 40 000 (dyzet mijë) USD-sh, për t’ia dhënë, si ndihmë financiare, për lehtësimin e pasojave, të shkaktuara nga tërmeti në provincën Sichuan, qeverisë së Republikës Popullore të Kinës.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha